UDHËZIM
Nr. 21, datë 3.10.2019

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR KUALIFIKIMIN, TRAJNIMIN DHE CERTIFIKIMIN E DREJTUESVE NË DETYRË TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 22, të ligjit nr. 48/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar gëzon ekskluzivitetin për administrimin e trajnimit e të certifikimit të detyrueshëm të drejtuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar.
2. Kriteret dhe procedurat për kualifikimin, trajnimin dhe certifikimin, organizimin e programit të zhvillimit profesional dhe vlerësimi i pjesëmarrësve, hartohen nga Shkolla e Drejtorëve dhe miratohen nga bordi drejtues i Shkollës së Drejtorëve, në të cilin marrin pjesë dhe përfaqësuesit e MASR-së.
3. Trajnimi i drejtuesve në detyrë zhvillohet me kohë të pjesshme, pa shkëputje nga puna.
4. Grafiku i kryerjes së trajnimit të detyrueshëm përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e institucioneve arsimore parauniversitare të drejtuesve në detyrë, kohëzgjatja, procesi i trajnimit të vazhdueshëm e trajnimeve të tjera, si dhe procesi i provimit e certifikimit, hartohen nga Shkolla e Drejtorëve dhe miratohen nga bordi drejtues i Shkollës së Drejtorëve, në të cilin marrin pjesë dhe përfaqësuesit e MASR-së.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shkolla e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini